

FJALA E DEPUTETES MERITA BAKIU

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar qytetarë,

Buxheti nuk është thjesht shifër, buxheti është instrument i politikës së qeverisë, është vendimmarrje, është buxheti i qytetarëve shqiptarë. Duke pasur specifike të tillë, duhet të projektohet me kujdes, për t'u shërbyer të gjitha fushave, ndaj kërkon analizë, konsultime dhe vullnetin e qeverisë. Buxheti duhet të hartohet për t'i shërbyer rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe në ndihmë të shtresave në nevojë, por, fatkeqësisht, ky buxhet nuk është në ndihmë të tyre.

Si anëtare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, do të fokusohem tek arsimit.

Diskutimi për buxhetin e arsimit është një ngjarje me rëndësi dhe me shumë përgjegjësi. Shërbimin që bën arsimit në përmirësimin e një kombi, ligji nuk e bën dot kurrë!

Si sektor i një rëndësie të veçantë, pavarësisht premtimit të qeverisë, që në vitin 2013, se buxheti për arsimin do të ishte 5% e GDP-së, këtë vit është afërsisht 3% dhe për vitin 2023, buxhetin e të cilit po marrim në shqyrtim, do të jetë afërsisht 2,3%.

Ju keni ripremtuar se do të jetësonit buxhetin 5% pas vitit 2017 në dokumentin zyrtar "Strategjia e arsimit parauniversitar 2016-2020", botuar në Fletoren Zyrtare më 19 janar 2016. Pra, duke u shprehur në mënyrë të përgjithshme mund të themi se objektivi kryesor, ai i rritjes së GDP-së për arsimin, jo vetëm nuk është realizuar, por ka zbritur krahasuar me 10 vjet më parë dhe krahasuar me vendet e rajonit.

Ministria e Arsimit dhe Sportit flet për shumë prioritete, por shumica e tyre janë marrë si nisma vite më parë, të cilat ose kanë ngelur në rrugë, ose kanë filluar dhe një pjesë e mirë e tyre kanë dështuar.

Le të flasim më konkretisht.

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka prioritet mbështetjen për trajnimin dhe punësimin e kategorive të veçanta, por nuk shpjegon në asnjë rresht të relacionit sesi duhej të bëhej punësimi dhe trajtimi i këtyre kategorive.

Ministria premtan rritjen e numrit të fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor, si dhe përfshirjen e klasave përgatitore në arsimin e detyrueshëm. Sipas “Strategjisë së arsimit parauniversitar”, në faqen 43 shkruhet: “Nga viti 2018, 95% e fëmijëve të grupmoshave 5 deri në 6 vjeç, përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara, bëjnë pjesë në klasat përgatitore”. Pra, ky objektivi është realizuar që në vitin 2018 dhe nuk ka nevojë për buxhete shtesë.

Në buxhet nuk shohim një zë kundër fenomenit të braktisjes së shkollës. Hartimi i programeve specifike për arsimin e grupeve të pafavorizuara deri në vitin 2023, ku çdo fëmijë rom dhe egjiptian do të regjistrohet në shkollë, 100% e tyre do të mbarojnë arsimin e detyruar dhe 70% e tyre arsimin e mesëm dhe të lartë, është një detyrim ligjor i përcaktuar me VKM dhe jo prioritet.

Lidhur me përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe shkollat me konvikte të reja sipas standardeve europiane, po në “Strategjinë e arsimit”, që nga viti 2018 shkollat e mesme janë të pajisura me infrastrukturën e sigurt. Ky prioritet është realizuar që në vitin 2018 dhe nuk ka nevojë për shtesë në buxhet.

Reduktimi i klasave kolektive është një prioritet i hershëm, i cili është diskutuar disa herë dhe nuk po merr zgjidhje.

Sigurimi i shërbimit të transportit, si dhe mbulimi i shpenzimeve të tij, për 35 mijë fëmijë dhe nxënës që e kanë vendbanimin e tyre 2 kilometra larg shkollës dhe për 12 mijë mësues që punojnë mbi 5 kilometra larg vendbanimit të tyre, është një detyrim ligjor dhe si i tillë nuk mund të jetë prioritet.

Lidhur me ofrimin e teksteve shkollore falas për 280 mijë nxënës që ndjekin arsimin bazë, nga klasa e parë në klasën e nëntë, edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një detyrim ligjor të vendosur nga qeveria vite më parë dhe nuk mund të quhet prioritet, por thjesht zbatim i ligjit.

Në gjykimin tonë, buxheti i paraqitur ka një sërë problematikash për arsimin. Aty bëhet fjalë për vitet 2022-2025 dhe, sigurisht, krijon bindjen e plotë se ky buxhet është më shumë elektoral dhe propagandistik sesa do t’i shërbejë zhvillimit të arsimit dhe rritjes së cilësisë. Këtë vit, vendi që zë buxheti për arsimin, në raport me prodhimin e përgjithshëm bruto, është vetëm 2,3%, pra shumë larg vendeve të rajonit dhe shumë larg premtimit qeveritar të vitit 2013.

Nuk është e qartë se si do të luftohet braktisja e shkollës, si do të rritet cilësia, si do të frenohet shpopullimi i zonave rurale dhe reduktimi i klasave kolektive; nuk kemi një plan të qartë për shtrirjen dhe aksesin e internetit në të gjitha zonat e vendit, veçanërisht në zonat e thella, për t'u dhënë shansin dhe mundësinë e barabarta të gjithë nxënësve, për të pasur një arsim sa më cilësor.

Projekti i famshëm i digjitalizimit nga klasat e gjashta deri në klasat e nënta nuk gjen pasqyrim në shifrat e buxhetit, të sjella nga qeveria. Ka shumë mundësi që ky projekt të përfundojë si ai i digjitalizimit të gjimnazeve në të gjithë vendin, për të cilin u shpenzuan rreth 9 milionë euro dhe ende nuk dihen ku janë ato tableta, në të cilat do të bënin mësim nxënësit e shkollave të mesme.

Mësuesve u është premtuar rritja e pagës prej 6%. Kjo shumë është qesharake dhe nuk mbulon dot as inflacionin, për më tepër kjo rritje aplikohet në muajin korrik. Pra, rritja e pagës do të jetë efektive vetëm për 5 muaj të vitit.

Ende flitet për përshtatje të infrastrukturës me kampe për fëmijët me aftësi të kufizuar, kur ne e dimë që shumë shkolla kanë mbetur në kushte mesjetare, pa ngruhje, pa laboratorë dhe pa kushtet minimale të mësimin.

Nuk është e qartë si do të trajtohen mësuesit, nëse do të vijnë të blejnë kreditë, apo si do të identifikohen nevojat për trajnimin profesional, duke përshtatur përgatitjen e mësuesit me zhvillimet më bashkëkohore në fushën e mësimdhënies.

Buxheti ka shumë pak investime për arsimin e lartë dhe premtime për kampuset universitare. Bazuar te qarku nga ku vij, kujtoj se universiteti i Durrësit nuk ka një godinë fjetjeje për studentët që nuk banojnë në këtë qytet.

Në këtë buxhet nuk ka një politikë të qartë, veç premtimeve që ngjajnë më shumë me propagandë sesa janë të realizueshme.

Faleminderit!